1. Autoriteti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

---

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës .....	
Shtojca 2. Lista e Çmimeve të Sherbimeve .....	
Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës .....	
Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial.....	
Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike .....	
Shtojca 6. Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit .....	
Shtojca 7. Termat e referencës	
Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve .....	
Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.....	
Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të Skualifikimit .....	
Shtojca 11 - Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak) .....	
Formulari 12 Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)	
Shtojca 13 : Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)	
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)	

---

## Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë t'i furnizojmë Autoritetit Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Shërbimeve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
  - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
  - 2. Njoftimin e Kontrates;
  - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
  - 4. Specifikimet teknike, grafikun e realizimit, termat e referencës;
  - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
  - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
  - 7. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

---

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë _____</b>	

**Shtojca 2.**

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):**  
\_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Shërbimet në Formularin e grafikut të realizimit për Shërbimet duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për Shërbim. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve**

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
<b>Shërbimi</b>	<b>Përshkrimi i shërbimi</b>	<b>Sasia</b>	<b>çmimi për njësi</b>	<b>Çmimi total për shërbim(3 x 4X)</b>	
1.	Mirembajtja e platformes elektronike te blerjes se energjise elektrike	12 / Muaj			
2.					
3.					
4					
	<b>Çmimi total (Shërbimet)</b>				_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					

---

<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

---

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)  
[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

#### Skicimet, parametrat teknik etj:

#### Specifikimi i Materialeve:

#### Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

#### TERMAT E REFERENCËS

### MIRËMBAJTJE E PLATFORMËS ELEKTRONIKE TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR NJË PERIUDHË 1 (NJË) VJEÇARE 2023-2024

#### TABELA E PËRMBAJTJES

1.	QËLLIMI I SHËRBIMIT .....	19
2.	OBJEKTI I SHËRBIMIT .....	19
3.	FUNKSIONIMI I MARRËVESHJES SË MIRËMBAJTJES.....	19
4.	AFATI I SHËRBIMIT.....	19
5.	ÇFARE ESHTË SISTEMI.....	20
5.1.	Përshkrim i Përgjithshëm.....	20
6.	OBJEKTI I MIRËMBAJTJES.....	20
7.	SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES.....	21
7.1	Disponueshmeria e sistemit .....	21
7.2	Kufizimet e mundshme ndaj disponueshmërisë së shërbimit .....	22
7.3	Kërkesat e shërbimit .....	22

---

<b>7.4</b>	<b>Raporti i shërbimit</b> .....	22
<b>7.5</b>	<b>Njoftimi i problematikave dhe i vlerësimeve periodike</b> .....	22
<b>8.</b>	<b>TERMAT E SHËRBIMIT</b> .....	22
<b>9.</b>	<b>PËRGJIGJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT</b> .....	23
<b>10.</b>	<b>KRITERET E VECANTA PËR KUALIFIKIM</b> .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

## 1. QËLLIMI I SHËRBIMIT

Qëllimi i këtij shërbimi, është ofrimi i shërbimit të mirëmbajtjes së platformës elektronike të blerjes së energjise elektrike për një periudhë (1) vjeçare .

## 2. OBJEKTI I SHËRBIMIT

Objektivi i përgjithshëm i këtij prokurimi është mirëmbajtja e platformës ekzituese elektronike të blerjes së energjisë elektrike për komponentet e mëposhtëm, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Mirëmbajtja e platformes elektronike ekzituese të blerjes së energjisë elektrike nënkupton pjesëmarrjen e të dy palëve, secili me aktivitetin përkatës, të ndarë parimisht në këto dy grupe:

- **Përfituesi i shërbimit, FTL SH.A,** ka për detyrë të kujdeset për mirëpërdorimin e sistemit, ambjentin ku është instaluar, të trajtojë përdoruesit e brëndshëm, të kërkojë në kohën dhe mënyrën e duhur suport për çështje teknike që nuk arrin t'i zgjidhe vetë.
- **Ofruesi i shërbimit,** ka për detyrë të zgjidhë problemet teknike të sistemit software të implementuar dhe dorëzuar në përfundim të periudhës së garancisë, referuar kërkesave për suport të Përfituesit, të japë informacion për sistemin dhe integrimin e mundshëm të tij me sisteme të tjera.

## 3. FUNKSIONIMI I MARRËVESHJES SË MIRËMBAJTJES

- Objekti i marrëveshjes së mirëmbajtjes është sistemi software i përshkruar në piken 6 te ketij dokumenti.
- Shërbimet e mirëmbajtjes të ofruara nga Operatori Ekonomik përshkruhen në piken 7 te ketij dokumenti.
- Termat e SLA (Service Level Agreement) specifikohen ne piken 8 të këtij dokumenti.
- Para kërkesës për suport teknik, Përfituesi do të bëjë cdo përpjekje për të identifikuar saktë problemin dhe për ta përshkruar në mënyrë të detajuar.
- Kërkesa për suport teknik nga Perfituesi do te vijë vetëm nga nje pike kontakti, e paraqitur në këtë marreveshje, dhe do të drejtohet vetëm në një pikë kontakti.
- Me fillimin e marreveshjes, Palet do të bëjnë një raport të gjëndjes funksionale të sistemit, përfshirë edhe gjëndjen e manualeve të sistemit në përdorim.

Me fillimin e marreveshjes Palet dakordojne mbi mënyrën e aksesit të sistemit nga Ofruesi.

## 4. AFATI I SHERBIMIT

Afati i shërbimit do të jetë për një periudhë 12 muaj nga lidhja e kontrates.

---

## 5. ÇFARE ESHTE SISTEMI

### 5.1. Përshkrim i Përgjithshëm

Qëllimi i kësaj platforme është të sigurojë rregulla dhe procedura të thjeshta për operime të shpejta, bazuar në një proces konkurrues dhe transparent për realizimin e blerjes së energjise elektrike pa cenuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike të klienteve.

Blerja e energjisë elektrike, nëpërmjet kësaj platforme zhvillohet në bazë të parimeve të transparencës, dhe të eficenses ekonomike, të cilat cojnë në përfitim ekonomik për Autoritetin Blerës. Keto rregulla hartohen në zbatim të Ligjit Nr.43/2015, date 25.05.2015 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, të ndryshuar, dhe VKM Nr. 456, date 26.06.2022 “Per miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licensuarve në sektorin e energjise elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”. Vendimi i Bordit të ERE Nr. 103, datë 23.06.2016 “Rregullore për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik” i ndryshuar.

Platforma e ndërtuar i vjen në ndihmë Bleresit (FTL SH.A,) për të gjitha ndërveprimet me Tregtarët e Licensuar përgjate procesit të blerjes, në ndërtimin dhe kategorizimin e regjistrit të Tregtarëve. Platforma ndihmon blerësin, në ndërtimin dhe drejtimin e Kalendarit të Ofertave dhe në automatizimin e proceseve, sipas procedurave standarte të blerjes së energjisë elektrike.

## 6. OBJEKTI I MIRËMBAJTJES

Më poshtë janë parashikuar funksionet dhe modulet për të cilat Perfituesi **FTL SH.A**, mund të kërkojë suport:

### 1. Komponentet/funksionet perberese te sistemit:

**Portali Web** i cili shërben për publikimin e informacionit me publikun e gjere, mbi:

- Aplikimet për regjistrim
- Suport në mbarevajtjen e aplikimit, plotesimit të formës , dërgimit të dokumentave.
- Kalendarin e ofertave,
- Suport në mbarëvajtjen e publikimit të informacionit sipas statuseve të përcaktuara.
- Transparençen e procesit
- Suport në gjenerimin e raporteve mbi proceset dhe rezultatet e fituesve.
- Ankesat
- Suport në mbarevajtjen e aplikimit të ankesës dhe mundësisë për të filtruar mbi to.
- Informacione të ndryshme të hapura për publikun.
- Suport në përditësimin/organizimin e informacionit.

### **Platforma e prokurimit:**

- Administrimi i përdoruesve
- Suport në mbarevajtjen e procesit të krijimit të përdoruesit dhe përcaktimit të rolit në sistem.
- Suport në menaxhimin e përdoruesve dhe aprovimet sipas proceseve të paracaktuara.
- Krijimi i përdoruesve të rinj.
- Fshirja e përdoruesve.
- Ndryshimi i të drejtave të përdoruesve.
- Aksesimi në portalin e blerjes së energjise
- Suport në mbarevajtjen e aksesimit të platformës sipas proceseve të përcaktuara në sistem.
- Kalendarin e ofertave

- 
- Suport në krijimin dhe menaxhimin e kalendarit të ofertave sipas proceseve të përcaktuara në sistem.
  - Suport në mbarevajtjen e krijimit të procedurës dhe publikimit të saj sipas proceseve të përcaktuara në sistem.
    - Vleresimi i ofertave/Votimi
  - Suport në mbarevajtjen e procesit të votimit sipas proceseve të përcaktuara në sistem.
    - Optimizimi
  - Suport në mbarevajtjen e procesit të votimit sipas proceseve të përcaktuara në sistem.
    - Ankesa
  - Suport në mbarevajtjen e procesit të votimit sipas proceseve të përcaktuara në sistem.
    - Notifikime
  - Suport në mbarevajtjen e dërgimit të notifikimeve sipas proceseve të përcaktuara.
  - Suport në ndryshime të përmbajtjes apo personave përgjegjës në dërgimet e email-eve.

## **2. Mbështetje për përdoruesit e sistemit**

- Për përdoruesit e brëndshëm të FTL SH.A,
- Për përdoruesit e jashtëm (Tregtarët e licensuar) që lidhen përmes VPN me sistemin, për vendosjen fillestare të lidhjes dhe konfigurimet përkatëse.

## **3. Kërkimet dhe Raportet**

- Përdorim normal i kërkimit: kthim i saktë i informacionit.
- Përcaktimi/Sugjerimi i kushteve për të realizuar një kërkim.
- Raporte për ERE dhe raporte finale të brëndshme në përfundim të procedurave

## **4. Shërbime IT**

- Mbështetje në rastet kur FTL SH.A, njofton për renie të pjesshme apo të plotë shërbimit.
- Mbështetje në rastet kur FTL SH.A, njofton për performancë të ulët të sistemit.
- Mbështetje për personelin e FTL SH.A, për kryerjen e procedurave të mirëmbajtjes IT.
- Përditësim i dokumentacionit të sistemit (dokument teknik dhe manuale përdorimi).
- Shpjegimi i principeve të përgjithshme të integritetit të produktit me sisteme të treta duke përdorur dokumentimin ose materialet e trajnimit.
  - Pyetje mbi përdorueshmërinë e sistemit të ofruar, politikave të aksesit, përdoruesit dhe rolet.
  - Mirëmbajtje pajisje Hardware Tokens.
  - Mirëmbajtje FIREWALL

## **7. SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES**

FTL SH.A, kërkon plotësimin e kushteve për nivelin e shërbimit të mirëmbajtjes sipas pikave më poshtë:

### **7.1 Disponueshmeria e sistemit**

Sistemi duhet të jetë i disponueshëm, funksional dhe i aksesueshëm nga përdoruesit, pa pasur defekte 99.9% të kohës në 24/7/365.

Përgjashtim bëjnë rastet kur disponueshmëria ndërpritet për shkaqe të tjera dhe jo për faj të ofruesit

---

të shërbimit. Hapsirat kohore për mirëmbajtje të planifikuara në sistem nuk ndikojnë në matjen e disponueshmërisë

## **7.2 Kufizimet e mundshme ndaj disponueshmërisë së shërbimit**

Mirëmbajtja e planifikuara e sistemit kryhet jashtë intervaleve kur ka operacione të shitjes së energjisë. Ofruesi i shërbimit duhet sigurohet që procesi i mirëmbajtjes të përfundojë para fillimit të operacioneve tregëtare. Mirëmbajtja e paplanifikuara e sistemit kryhet jashtë intervalit të operacioneve tregëtare dhe në çdo kohë. Ofruesi i shërbimit duhet të përpiqet dhe të vërë në dispozicion të gjithë kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe teknike që procesi i mirëmbajtjes të përfundojë para fillimit të transaksioneve tregëtare të shitjes së energjisë.

## **7.3 Kërkesat e shërbimit**

Problematikat e njoftuara nga FTL SH.A, ose të kontatuara nga ofruesi i shërbimit duhet të gjejnë zgjidhje Brenda 34 orëve nga koha e njoftimit. Në rastet kur nevojitet më tepër kohë, Afati I parashikuar për zgjidhjen e problemit duhet të njoftohet, I shoqëruar me arsyetimin. Në rastin kur afati parashikohet më shumë se 1 (një ) javë ai miratohet nga ndjekësit e kontratës.

Shërbimi i mirëmbajtjes/mbështetjes nga ofruesi i shërbimit do të kryhet me paraqitje në ambientet e FTL SH.A. ose me qasje në distancë (remote acces), e cila do të përcaktohet nga përfaqësuesit e DTI (Departamentit të Teknologjisë së Informacionit). FTL SH.A, rezervon të drejtën e mbikeqyrjes fizike ose online , në kohë reale, të të gjithë procesit të dhënies së shërbimit të mbështjetjes. Gjithashtu, FTL SH.A. mundëson për punonjësit përgjegjës të ofruesit të shërbimit vetëm të drejta qasjeje të përkoshme në sistemet TIK që preket shërbimi i mbështetjes.

## **7.4 Raporti i shërbimit**

Raportimi mbi problematikat e njoftuara dhe ecurinë për zgjidhjen e tyre do të kryhet çdo muaj. Raporti do të dorëzohet:

- me email dhe me dokument të protokolluar
- si dokument, me mundësinë për t'u shkarkuar, në një portal për ndjekjen e problematikave.

## **7.5 Njoftimi i problematikave dhe i vlerësimeve periodike**

Njoftimi për shfaqjen dhe zgjidhjen e problematikave do të kryhet:

- Me e-mail dhe me dokument të protokolluar
- Në një portal për ndjekjen e problematikave

Portali për ndjekjen e problematikave (support ticket system) do të vihet në dispozicion dhe mirëmbahet nga ofruesi i shërbimit të mbështjetjes, duke mundësuar qasjen për punonjësit përgjegjës të FTL SH.A,

## **8. TERMAT E SHËRBIMIT**

Kërkesat ndaj suportit teknik klasifikohen në disa nivele shërbimi. Nivelet e shërbimit diferencohen nga koha e përgjigjes dhe parametrave të tjerë; në varësi gjithashtu të teknologjisë dhe/ose marrëveshjeve të nivelit të ndërveprimit me palë të treta.

Kërkesat e suportit teknik procesohen sipas parimit: cila vjen e para, shërbehet e para. Koha maksimale e përgjigjes përcaktohet nga niveli i shërbimit përkatëse. Kërkesat me prioritet 1 dhe 2, të cilat kërkojnë përgjigje urgjente ose ndihmë direkte nga specialistët e suportit teknik mund të procesohen jashtë rradhe. Koha e zgjidhjes së problemit varet nga niveli i urgjencës së problemit, kompleksitetit dhe nevojës potenciale për t’ja kaluar kërkesën departamentit të zhvillimit.

Suporti teknik do të bëjë përpjekjet maksimale për të garantuar kohët e parashikuara të ndërhyrjes dhe zgjidhjes së problemeve. Në këtë aspekt duhet patur parasysh që ka një numër faktoresh ndikues: përgjigjet në kohë të klientit; koha e përgjigjes së një pale të tretë; nevoja për të përgatitur dhe nxjerre një version të softuerit, ditet e pushimit, etj.

## 9. PËRGJIGJA DHE SHKALLËZIMI I SHËRBIMIT

Kohët maksimale që marreveshja synon të garantojë janë të përcaktuara më poshtë. Nivelet e mëposhtme të shërbimit të suportit sigurohen nga grupi i suportit teknik të operatorit ekonomik, gjatë ditëve të punës (e Hënë- e Premte) brënda orarit të punës.

Në rast se klienti ka kërkesa të avancuara për suportin teknik jashtë kohës së përmendur, mund të rishikohen kushtet e suportit kundrejt një marrëdhënie të ndryshme financiare.

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre gjatë periudhës së mirëmbajtjes

Në tabelën e mëposhtme përcaktohet kategorizimi i seriozitetit të problemeve dhe koha e përgjigjes për zgjidhjen e tyre.

Kategoria A (Kritik/ I Lartë)	Kategoria A (I Mesëm)	Kategoria C (I Ulët)
Mos funksionimi i aplikacionit krijon apo rrezikon shumë aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit krijon vonesa në aktivitetin normal	Mos funksionimi i aplikacionit pengon në mënyrë minimale aktivitetin
<b>Numri i përdoruesve të ndikuar</b>		
Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër <b>shumë të madh</b> të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon një numër të <b>vogël</b> të përdoruesve	Mos funksionimi i sistemit ndikon pjesërisht në disa përdorues
<b>Pezullimi i punës</b>		
Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të <b>realizojnë pjesën më të madhe të punës së tyre.</b>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të <b>realizojnë pjesë të punës së tyre</b>	Mos funksionimi i sistemit pengon përdoruesit të <b>realizojnë disa pjesë të vogla të punës së tyre,</b>
<b>Zgjidhje alternative e përkohëshme</b>		
<b>Nuk ka një mënyrë alternative</b> të përkohëshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit	<b>Ka pjesërisht një mënyrë alternative</b> të përkohëshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.	<b>Ka një mënyrë alternative</b> të përkohëshme dhe të pranueshme për zgjidhjen e problemit.
<b>Koha e përgjigjes</b>		

o 10 min. për të kthyer pergjigje o Në vend brenda 1 ore.	o 30 min. për të kthyer pergjigje o Ne vend brenda 2 orëve	o 60 min. per të kthyer pergjigje o Ne vend brenda 4 orëve
<b>Koha e zgjidhjes</b>		
Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 4 orë pas kërkesës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është brenda 2 ditëve te punës.	Maksimumi i pranimit të zgjidhjes është 10 ditë kalendarike.

### **Të drejtat e kodit të aplikacionit**

Çdo e drejtë mbi kodin burim për çdo komponent të sistemit apo çdo dokumentacion që ka të bëjë me sistemin e ndërtuar nga Kontraktori duhet t'i kalojë (Përfituesit) në format elektronik dhe në dokument.

---

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimet që kërkohen që kërkohen: Mirembajtja e platformes elektronike te blerjes se energjise elektrike**

**Afatet e ekzekutimit: 12 Muaj**

<b>Shërbimet</b>	<b>Përshkrimi</b>	<b>Shuma</b>	<b>Vendi i ekzekutimit</b>	<b>Afati i ekzekutimit</b>

---

## Shtojca 7

( Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

### TERMAT E REFERENCES

**Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:** Mirembajtja e platformes elektronike te blerjes se energjise elektrike

**Detyrat:** Objektivi i përgjithshëm i këtij prokurimi është mirembajtja e platformës ekzistuese elektronike të blerjes së energjisë elektrike për komponentet e mëposhtëm, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së punës.

Mirëmbajtja e platformes elektronike ekzistuese të blerjes së energjisë elektrike nënkupton pjesëmarrjen e të dy palëve, secili me aktivitetin përkatës, të ndarë parimisht në këto dy grupe:

- **Përfituesi i shërbimit, FTL SH.A,** ka për detyrë të kujdeset për mirëpërdorimin e sistemit, ambjentin ku është instaluar, të trajtojë përdoruesit e brëndshëm, të kërkojë në kohën dhe mënyrën e duhur suport për çështje teknike që nuk arrin t'i zgjidhe vetë.
- **Ofruesi i shërbimit,** ka për detyrë të zgjidhë problemet teknike të sistemit software të implementuar dhe dorëzuar në përfundim të periudhës së garancisë, referuar kërkesave për suport të Përfituesit, të japë informacion për sistemin dhe integrimin e mundshëm të tij me sisteme të tjera.

Shpërndarja:

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: sipas specifikimeve

---

## Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale; dh nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

---

## **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

---

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Per te provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomike duhet te paraqesin vertetim per xhiron vjetore per vitet financiare 2020, 2021, 2022, ku vlera e xhiros per te pakten nje nga vitet e periudhes se kerkuar duhet te jete jo me e vogel se 1,400,000 (Nje milion e katerqind mije) leke.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2020, 2021, 2022**, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.*

---

## 2.3 Kapaciteti teknik:

**2.3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit (2020, 2021, 2022) nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 700,000 (Shtateqind mijë) leke pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i certifikuar sipas standardeve ndërkombëtare. Për këtë arsye, operatori ekonomik ofertues duhet të zotëroje certifikatat e mëposhtme të vlefshme në datën e hapjes së tenderit të perkthyer dhe të noterizuara:

- a) *ISO 9001 ose ekuivalente të sistemit të menaxhimit të cilësisë (e vlefshme).*
- b) *ISO 27001 ose ekuivalente për Sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit” (e vlefshme).*
- c) *ISO/IEC 20000-1 ose ekuivalente për menaxhimin e shërbimeve të teknologjive të informacionit (e vlefshme).*

Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas fushës së objektit që do të prokurohet.

Certifikatat të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

*Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 88 të VKM-285 datë 19.05.2021, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrin përsipër të realizojnë sipas akt-marrëveshjes paraprake.*

**2.3.3** Operatori ekonomik Ofertues duhet të disponojë minimalisht 6 punonjës, ku:

- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për sigurinë e informacionit.**
- **Të paktën 2 (dy) punonjës të certifikuar për mbështetjen e projektit sipas praktikave të ITIL ose ekuivalente**
- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për siguri në rrjetat kompjuterike**
- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për administrim databaze**
- **Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar për testim software**

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Listepagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore për periudhën Tetor 2023 të konfirmuara nga administrata tatimore.

---

*Për të përmbushur këto kritere, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë dhe certifikimet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, me njoftimin praparak te fituesit, te gjitha dokumentat e vetedeklaruara do te dorezohen prane AK origjinale ose kopje te noterizuara.*

**SHENIM:** *Një punonjës mund te ketë 1 ose disa certifikime.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shenim:** *Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, në mbeshtetje te përcaktimit te nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti / enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”, për rrjedhojë, ofertuesi i kualifikuar i pari, duhet te plotesoje sa mesiper.*

**Shtojca 9.**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigja</b>
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- --
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- -
E-mail:	----- -----

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: <ul style="list-style-type: none"><li><b>Informacione për nënkontraktorin</b></li></ul>
--

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

## Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

### A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarimënësë vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit</p>

të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* \_\_\_\_\_

